REDAKSIA:
Prof. Jorgo BULO, Prof. Emil LAFE
Prof. Seit MANSAKU, Prof. Enver HYSA

FORMULIMI GRAFIK:
Enkelejda MISHA

© Copyright: Akademia e Shkencave e Shqipërisë
- Të gjitha të drejtat të rezervuara -

Shtypur në shtypshkronjën "DITA 2000", Tiranë 2003

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
INSTITUTI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

KONFERENCA SHKENCORE "SHQIPJA STANDARDE DHE SHOQËRIA SHQIPTARE SOT"

Tiranë, 11-12 nëntor 2002

Shtëpia botuese "Shkenca"

se në mjaft raste ajo nuk pasqyron shqiptimin e sotëm real, me shkrimin e emrave të përveçëm, me drejtshkrimin e fjalëve me origjinë të huaj apo edhe me përdorimin e shkronjës së madhe.

4.Pasurimi i mëtejshëm i shqipes me fjalë të brumit të saj dhe sidomos pastrimi i shqipes nga fjalët e huaja të panevojshme, të cilat kanë vërshuar ditët e sotme, të jetë edhe këndej e tutje në qendër të vëmendjes sonë.

Në këtë mes një rol të dorës së parë duhet të luajë shteti, i cili duhet të organizojë e të drejtojë, përmes organeve të specializuara të tij, një politikë të drejtë gjuhësore, ku masa e parë dhe e domosdoshme mendojmë se do të ishte futja e gjuhës shqipe në shkollën e mesme e, ndoshta, në disa drejtime edhe në shkollën e lartë. Prandaj, duhet të mos mjaftohemi vetëm me konstatime, me vërejtje, por ato mendime e propozime t'i vemë në jetë, në mënyrë që të mos ecet pa një perspektivë të qartë, në mënyrë që gjuhën standarde ta ngremë në një nivel të atillë, që ajo të përmbushë e të plotësojë nevojat jo vetëm të shoqërisë së sotme shqiptare, por edhe të perspektivës.

Është e nevojshme gjithashtu që të bëhen përpjekje për ta pasuruar standardin me elemente të reja gjuhësore mbarëkombëtare, që përfaqësojnë një areal sa më të gjerë gjuhësor, për ta plotësuar, saktësuar e përgjithësuar me forma të përbashkëta të truallit shqiptar, duke i shtuar ato e duke hequr pikërisht elementet që nuk i ka përqafuar gjuha e sotme shqipe.

[1] Lidhur me këtë dhe të dhëna të tjera, shih më gjerësisht disertacionin e doktoratës së N. Veselajt me titull *"Struktura fjalëformuese te emërtimet e njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe"* (dorëshkrim). Prishtinë, 1991.

Viktor FRIDMAN (Victor FRIEDMAN)
Çikago

SHQIPJA STANDARDE NË AMERIKË: STUDIME SHKENCORE, PEDAGOGJIKE DHE PLANIFIKIMI GJUHËSOR

Nga pikëpamja gjuhësore dhe simbolike, dy ngjarjet më të rëndësishme për standardizimin e gjuhës shqipe në shekullin e njëzetë kanë qenë Kongresi i Manastirit në vitin 1908 dhe Kongresi i Drejtshkrimit në vitin 1972. Që të dyja ishin ngjarje me efekte edhe jashtë Ballkanit, veçanërisht në Amerikë. Në këtë kumtesë dëshiroj të vështroj disa momente nga historia e standardizimit të gjuhës shqipe në Amerikë përkitazi edhe me gjendjen e sotme.

Standardizimin e gjuhës shqipe nga pikëpamja amerikane mund ta vështrojmë në tre aspekte: 1) konteksti mërgimtar, 2) konteksti akademik, dhe 3) konteksti qeveritar, të cilët sidoqoftë janë kategori që mbivendosen me njëra-tjetrën.

Siç e dinë mirë albanologët, por jo qytetarët në përgjithësi, në Shtetet e Bashkuara gazeta "Dielli", botuar në Boston që nga viti 1909, është gazeta më vjetër në botë në gjuhën shqipe që është botuar pa ndërprerje. Por para "Diellit" ishte botuar gazeta "Kombi" në Boston, që ishte gazeta e parë shqipe botuar në Amerikë. Gazeta "Kombi" mori pjesë në debatet për drejtshkrimin e gjuhës shqipe, dhe pronari e redaktori i gazetës, Sotir Peci, një mërgimtar nga Dardha e Korçës, ishte delegat nga Amerika i Kongresit të Manastirit. Vështirësitë e shkaktuara nga mungesa e standardizimit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe në fillimin e shekullit të njëzetë u vështruan edhe në faqet e "Kombit". Për shembull, në një letër të vitit 1909 nga shoqëria "Marësia", shkruhet: "Gjanë të turpënohemi kur qillon ngahera e na thotë nonji i huj: 'Dua të mësoj gjuhën shqipe, po s'mundem, se ju keni ma se dhitë abetare.'" Në vitin 1909, pas Kongresit, debati vazhdoi në faqet e "Diellit",

ku shkruhet në mënyrë kritike për faktin se: "S'pati trimërinë të bëj detyrën e tij dyke pëlqyer një abece." Mirëpo edhe albanologu i njohur Holger Pedersen botoi një letër në "Dielli", ku çmoi Kongresin si një hap përpara. Është interesante të vështrojmë se 90 vjet më pas një tjetër albanolog i njohur, prof. Eric Hampi, në një kumtesë të shkurtër në Universitetin "Ohajo Stejt" (Ohio State) në Amerikë propozoi një reformë të drejtshkrimit të sotëm për të pranuar edhe zanoret hundore të gegërishtes së bashku me *ë*-në e toskërishtes.

Siç e dimë, me kohë, alfabeti shqip u njësua në praktikë. Mirëpo çështja e njësimit të bazës dialektore mbeti ende e pazgjidhur. Situata midis dy luftërave botërore u pasqyrua në Amerikë, veçanërisht në kontekstin mërgimtar. Për shembull, në vitin 1923 Kostë Çekrezi botoi në Boston (me alfabetin latin, por me një parathënie të Faik Konicës në alfabetin e Stambollit) një "Fjalor inglisht-shqip" - i pari fjalor i tillë pas Luftës së Parë Botërore. Fjalori ishte toskërisht, kurse në të njëjtën kohë në faqet e gazetës "Dielli" përdorej edhe elbasanishtja si në Shqipëri, d.m.th. se në Amerikë si në Shqipëri nuk kishte një gjuhë të njësuar. Në kontekstin akademik, megjithëse kishte studime për gjuhën shqipe të botuara para Luftës së Dytë Botërore (p.sh. artikulli i G. S. Lowmenit në revistën "Language" [1932] për fonologjinë e së folmes së Shkodrës), vetëm pas luftës filloi hartimi i studimeve doktorale për gjuhën shqipe. Sipas situatës në Shqipëri dhe jashtë saj, doktoratat për gjuhën shqipe në Amerikë ishin studime për çështje dialektore, si studimi folklorik i Stavo Skendit (Columbia 1951), studimi për një të folme arbëreshe i Eric Hampit (Harvard 1954), studimi i toskërishtës së Beratit i Leonard Newmarkut (Indiana 1955), etj. Vetëm në vitin 1970 kemi studimin e parë për gjuhën standarde të Shqipërisë nga Geri Bevingtoni (Universiteti Massaçusetts) dhe pastaj në vitin 1973 studimin e G. Byronit (Universiteti Pennsylvania) për gjuhën e njësuar.

Mirëpo gjatë gjithë kësaj periudhe deri në Kongresin e Drejtshkrimit edhe tekstet mësimore për gjuhën shqipe për të huaj ishin të ngarkuara me vështirësitë e kësaj situate, ku s'kishte një normë të njësuar - gjë që ishte shumë e vështirë për studentët - mu siç shkruhej në letrën nga shoqëria "Marësia" në fillim të shekullit. Një shembull shumë ilustrues ishte një libër i viteve '60 nga Fehime Pipa, botuar nga "Vatra" me titullin "Filltar i shqipes". Megjithëse libri fillonte në gjuhën standarde të Shqipërisë, në mësimin e tretë takojmë një fqinjë gege që flet gegërisht dhe në mësimin 16 edhe një murator që flet arbërisht. Megjithëse ky format pasqyron pasurinë e gjuhës shqipe, nga pikëpamja pedagogjike efekti për studentët e huaj është i njëjtë me problemin e alfabetit të cituar më sipër.

Kur kemi të bëjmë thjesht me çështje të morfologjisë, të cilat trajtohen në fjalorët drejtshkrimorë, një fenomen që është interesant për dialektologun, është

kokëçarës për studentët. Për shembull, prej fjalës *pres* kemi *prisni* dhe *pritni* dhe nga këto dy baza kemi dy paradigma për të pakryerën: *pritja, pritje* etj., ose *prisja, prisje* etj. Prej foljes *gjen* kemi katër mundësi për joveproren: *u gjet, u gjind, u gjend, u gjënd.* Habitorja e foljes *ha* mund të jetë *hëngërka, hangërka* ose *ngrënka*. Prej foljes *rri* kemi katër pjesore: *ndenjur, ndënjur, ndejtur, ndëjtur* etj.etj. Domethënë pasuria e formave është vështirësia e mësimit të gjuhës shqipe. Pasuria e gjuhës shqipe është për të kremtuar, por edhe forma e shqipes së njësuar ka vendin e saj.

Në lidhje me këtë le të themi diçka edhe për gegërishten dhe toskërishten në Amerikë. Para Luftës së Dytë Botërore dhe për shumë dekada pas saj, pjesa më e madhe e shqiptarëve të Amerikës flisnin toskërisht. Figurat më të shkëlqyera të shqiptarëve të Amerikës ishin toskë, Fan Noli dhe Faik Konica, dhe që të dy ishin njerëz edhe të letrave e të gjuhës. Megjithatë edhe elbasanishtja u përdor në "Dielli". Pas vitit 1981 kemi edhe më tepër gegërishtfolës në Amerikë. Duhen përmendur edhe shkrimtarët gegë si Arshi Pipa në Amerikë dhe Martin Camaj në Gjermani (por me shumë lidhje me Amerikën), që vazhduan të kujdesen për gegërishten, madje edhe pas vitit 1972. Në qoftë se lëmë mënjanë politikën dhe mendojmë vetëm për estetikën dhe shkencën, tradita e pasur dydialektore e gjuhës shqipe ka një vend në kulturën e botës.

Fjalori shqip-anglisht i Newmark-ut më 1998 pasqyron këtë. Nga ana tjetër, një arritje si gjuha e njësuar është një thesar që duhet të ruhet. Çdo gjuhë në botë ndryshon. Anglishtja e Shekspirit nuk është anglishtja e Dikensit dhe as njëra e as tjetra nuk është anglishtja e sotshme. Sidoqoftë, anglishtja ka vetëm një standard, megjithëse ka variante. Mirëpo çdo gjuhë ka nevojat e veta. Sfida për shqipen në Amerikë në shekullin XXI do të jetë të ruajë arritjet e Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972 së bashku me zhvillimet moderne. Dhe me lidhjet që ka tani bashkësia shqiptare e Amerikës me botën shkencore shqiptare, kjo do të bëhet.